



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 244/2018

Datë: 30 maj 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 30 maj 2018-KPK/Nr. 243/2018, shpall:

SHPALLJE E BRENDSHME

Për avancim të prokurorëve të shtetit

- I. Pesë (5) pozita për prokurorë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
- II. Kandidatët e interesuar për avancim duhet të plotësojnë këto kriterë:
 1. Për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, prokurori duhet t'i plotësojë kushtet për të punuar si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda, si dhe të ketë vlerësimin pozitiv të performancës;
 2. Të kenë mandat të përhershëm;
 3. Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përveç qortimit.
 4. Pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me procedurën penale, mjetet juridike, praktikat juridike të gjykatave vendore dhe ndërkombëtare do të merret parasysh.
- III. Kandidati që parashtron kërkesë për avancim duhet të dorëzojë edhe dokumentet si në vijim:
 1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
 2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;

3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë për avancim.

V. Afati për dorëzimin e kërkesës për avancim është nga data 06 qershor 2018 deri me datë 20 qershor 2018.

VI. Kërkesa për avancim duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e parë (1) të ish ndërtesës së EULEX-it, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 18, të mbyllura në zarf, ose me postë.